



ZHVILLIMI GJITHËPËRFSHIRËS EKONOMIK

DEKLARATË VJETORE E PROGRAMIT #1

NR. I DVP-SË: APS-2023-01

Lëshuar nga:	Zhvillimi Gjithëpërfshirës Ekonomik (IEEA) - financuar nga USAID dhe zbatuar nga CDF.
Data e leshimit:	31 mars 2023
Data e mbylljes:	8 shtator 2023, në orën 16:00, Koha e Evropës Qendrore. Inkurajohen aplikimet e hershme.
Lënda:	Thirrje për NMVM-të në pronësi të grave dhe të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë për Shprehje të Interesit (SHI) për financim të projekteve për mallra dhe shërbime që synojnë përmirësimin e qëndrueshmërisë së tyre të përgjithshme.
Qëllimi:	Përmes kësaj thirrjeje, ftohen NMVM-të të cilat përmbushin kushtet për aplikim që të shprehin interesim dhe të aplikojnë me projekte duke ju përmbajtur një qasjeje dhe metodologjie teknike kreative në drejtim të përmbushjes së objektivës së Aktivitetit për fuqizimin dhe ringjalljen e ndërmarrjeve Mikro, të Vogla dhe të Mesme (NMVM) në pronësi të grave dhe të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë, të ndikuara negativisht nga pandemia e shkaktuar nga Covid-19.
E drejta për aplikim:	Kandidatët me të drejtë aplikimi përfshijnë NMVM-të e regjistruara ligjërish në pronësi të grave dhe NMVM-të e regjistruara ligjërish në pronësi të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në Kosovë.
Mbështetja financiare:	Mbështetja financiare do të jetë deri në 10,000 USD.
Informatë:	Ekipi i IEEA-së do të organizojë sesionin fillestar të informimit lidhur me këtë thirrje përmes internetit. Sesioni online do të organizohet më 18 Prill 2023 duke filluar nga ora 10:00, paradite.
Vegëzat përmes internetit:	Vegëza për seancën online do të publikohet në: Faqen e internetit të CDF në https://kcdf.org/ dhe në faqen e Facebook-ut të CDF në https://www.facebook.com/CommunityDevelopmentFund . Përveç kësaj, sesione informuese lidhur me DVP-në do të organizohen në 7 regjione të Kosovës. Një orar specifik për seancat informuese do të publikohet në faqen e internetit të CDF në: https://kcdf.org/ dhe në faqen e CDF në Facebook në: https://www.facebook.com/CommunityDevelopmentFund

RRETH PROJEKTIT

Zhvillimi Gjithëpërfshirës Ekonomik (IEEA) (në tekstin e mëtejshëm “IEEA” ose “Aktiviteti”) është një aktivitet pesëvjeçar me qëllim të fuqizimit të grave dhe pjesëtarëve të komuniteteve pakicë përmes rritjes së mundësive ekonomike në mbarë Kosovën. Ky aktivitet synon të ofrojë ndihmë të shpejtë dhe urgjente për gratë dhe pjesëtarët e komuniteteve pakicë që historikisht janë përjashtuar nga mundësitë ekonomike në Kosovë dhe janë të prekur në mënyrë disproporcionale nga ndikimi negativ ekonomik i COVID-19, si dhe t'i ndihmojë ata/ato të bëhen më të qëndrueshëm dhe të përballojnë vështirësitë apo shqetësimet në të ardhmen.

SEKTORËT KYÇ

Projekti Zhvillimi Gjithëpërfshirës Ekonomik do të fokusohet në të gjithë sektorët ku veprojnë NMVN-të në pronësi të grave dhe pjesëtarëve të pakicave.

FUSHAT NË FOKUS

Fushëveprimtaria e projektit Zhvillimi Gjithëpërfshirës Ekonomik (IEEA) përqëndrohet në pesë fushat e mëposhtme:

- Qasjen në financa: NMVM-të në pronësi të grave dhe pjesëtarëve të komuniteteve pakicë shpesh përballen me sfida që kanë të bëjnë me qasjen në kapital. Programet e granteve dhe asistencës mund të fokusohen në ofrimin e mbështetjes financiare për këto biznese për t'i ndihmuar ato të rriten dhe zgjerohen.
- Zhvillim të biznesit: Ofrimi i trajnimeve dhe mbështetjes për NMVM-të në pronësi të grave dhe pjesëtarëve të komuniteteve pakicë mund t'i ndihmojë këto biznese të zhvillojnë aftësi më të forta në fusha të tilla si marketingu, shitjet dhe veprimtaritë biznesore.
- Teknologji dhe inovacion: NMVM-të në pronësi të grave dhe pjesëtarëve të komuniteteve pakicë mund të përfitojnë nga qasja në teknologjitë e reja dhe zgjidhjet inovative që mund t'i ndihmojnë ata/ato të konkurrojnë në treg.
- Qasje në tregje: Programet e asistencës mund të ndihmojnë NMVM-të në pronësi të grave dhe pjesëtarëve të komuniteteve pakicë të kenë qasje në tregje dhe klientë të rinj, të cilët mund t'i ndihmojnë atyre të rrisin bizneset dhe të ardhurat e tyre.
- Rrjetëzim dhe mentorim: NMVM-të në pronësi të grave dhe pjesëtarëve të pakicave mund të përfitojnë nga mundësitë e rrjetëzimit dhe mentorimit që i lidh ata/ato me pronarë të tjerë biznesi dhe ekspertë të industrisë, të cilët mund të ofrojnë udhëzime dhe mbështetje.

QËLLIMI I MBËSHTETJES FINANCIARE

Nëpërmjet kësaj mundësie të financimit, IEEA fton aplikuesit e kualifikuar që të paraqesin propozime për financimin e zgjidhjeve apo ideve konkrete që synojnë fuqizimin dhe ringjalljen e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) në pronësi të grave dhe pjesëtarëve të komuniteteve pakicë të ndikuara negativisht nga pandemia e shkaktuar nga COVID-19.

KUFIZIMET (VËSHTIRËSITË) E PËRGJITHSHME

IEEA ka kryer së fundmi një vlerësim të gjendjes së përgjithshme të NMVM-ve në pronësi të grave dhe pjesëtarëve të komuniteteve pakicë në Kosovë, në bazë të të cilit u identifikuan disa sfida me të cilat përballen këto biznese si rezultat i pandemisë së COVID-19. Këto kufizime po pengojnë rritjen dhe qëndrueshmërinë e tyre.

Disa nga kufizimet (vështirësitë) kryesore që u identifikuan përfshijnë:

- a) Qasjen e kufizuar në financa
- b) Mungesën e kapaciteteve për zhvillimi të biznesit
- c) Mungesën e fuqisë punëtore dhe mungesën e shkathtësive
- d) Mungesën e pajisjeve
- e) Mungesën e dixhitalizimit/e-biznesit
- f) Integrimin e kufizuar të zinxhirit të vlerës dhe qasjes në treg
- g) Mungesën e mundësive të rrjetëzimit dhe kufizime në zgjerimin e veprimtarive të biznesit
- h) Praktikrat joformale të biznesit

Aplikuesit për mbështetje financiare sipas kësaj thirrje duhet të demonstrojnë qartë se si propozimet e tyre adresojnë të paktën një nga kufizimet (vështirësitë) e identifikuar.

REZULTATET KRYESORE TË DËSHIRUESHME

Aplikacionet e paraqitura sipas kësaj thirrje pritet që të demonstrojnë se si kërkesat e tyre për financim dhe aktivitetet e propozuara kontribuojnë në të paktën një nga treguesit e rezultateve të përmendura më poshtë. Ndërsa aplikimet vlerësohen nga këndvështrime të shumta, aplikacionet që dëshmojnë qartë një ndikim në të paktën një, por mundësisht në më shumë tregues rezultatesh të renditura më poshtë, do të kenë mundësi më të mëdha për të përfituar fonde:

- Përmirësimi i cilësisë së produkteve dhe/ose shërbimeve;
- Përmirësimi i efikasitetit si rezultat i pajisjeve të reja;
- Rritja e vlerës neto të shitjeve;
- Rritja e numrit të vendeve të punës, duke përfshirë gratë dhe pjesëtarët e pakicave;
- Rritja e dixhitalizimit të kompanive;
- Përmirësimi i qasjes në treg.

FUSHAT PRIORITARE PËR FINANCIM

Nëpërmjet kësaj thirrjeje për financim, IEEA mirëpret aplikacionet që synojnë qartë fuqizimin e NMVM-ve në pronësi të grave dhe/ose në pronësi të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë. Duke pasur parasysh se Aktiviteti synon një grup shumë specifik, ai nuk do të ketë ndonjë fushë prioritare të paracaktuar për financim, por do t'i përgjigjet nevojave specifike të bizneseve të synuara.

MADHËSIA E GRANTIT

në varësi të fondeve në dispozicion, secili grant që rezulton nga kjo thirrje pritet të jetë diku deri në **10,000 USD** për NMVM-të në pronësi të grave dhe pjesëtarëve të komuniteteve pakicë.

SHËNIM:

Inkurajohet bashkëfinancimi, por një gjë e tillë nuk është e detyrueshme dhe nuk do të paraqes asnjë përparësi gjatë procesit të vlerësimit. Për më tepër, bashkëfinancimi konsiderohet zgjidhje opsionale dhe nuk do të ndikojë në procesin e vlerësimit.

FINANCIMI I PRANUESHËM DHE I PAPRANUESHËM

Lista e shpenzimeve që IEEA do të konsiderojë të pranueshme dhe/ose të papranueshme për t'i mbuluar në një aplikacion të suksesshëm është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Lloji i partnerit	Të pranueshme për financim	Të papranueshme për financim
NMVM-të	Sipas formatit të Grantit, mallrat dhe shërbimet prokurohen drejtpërdrejt nga Projekti në bashkëpunim të ngushtë me përfituesin e grantit ose aktivitetin e grantit. Të gjitha procedurat e prokurimit të ndërmarra në emër të përfituesëve të granteve nga IEEA do të bëhen në përputhje me rregulloret e prokurimit të CDF-së dhe USAID-it.	<ul style="list-style-type: none">• Shpenzime të udhëtimit dhe akomodimit për anëtarët• Shpenzimet e ndërtimit• Pajisjet e përdorura• Shpenzimet operative

E DREJTA PËR APLIKIM

Të gjitha grantet e lëshuara nga fondet e IEAA do t'i nënshtrohen kriterëve për aplikim të përcaktuara më poshtë. Aplikuesit e kualifikuar duhet të jenë:

- NMVM të regjistruara ligjërisht në Kosovë në pronësi të grave
- NMVM të regjistruara ligjërisht në Kosovë në pronësi të pjesëtarëve të komuniteteve pakicë
- NMVM të regjistruara ligjërisht në Kosovë në pronësi të grave dhe pjesëtarëve të komuniteteve pakicë

Aplikuesit me të drejtë aplikimi duhet gjithashtu të:

- Demonstrojnë aftësi për të kontribuar në objektivat e IEAA dhe për të përmbushur qëllimet e grantit në përputhje me politikat dhe praktikën e USAID dhe CDF.
- Paraqesin një formë të menaxhimit të shëndoshë financiar, administrativ dhe teknik në formën e një sistemi kontrollësh që mbron asetet dhe mbron nga mashtrimi dhe shpërdorimi.
- Mbështesin arritjen e objektivave të grantit.
- Të kenë një histori të kënaqshme të performancës dhe të integritetit dhe etikës së biznesit.

Aplikuesit pa të drejtë aplikimi janë:

- Partitë apo institucionet politike.
- NMVM-të që mbrojnë, promovojnë ose përkrahin politika antidemokratike ose aktivitete të paligjshme.
- NMVM-të që synojnë të përdorin fondet për qëllime fetare.
- Subjektet që kanë keqpërdorur fondet e USAID-it në të kaluarën.
- NMVM-të me pjesëtarë kyç që janë të përfshirë në:
 - Listën e Zyrës së Kontrollit të Pasurive të Huaja (OFAC) të shtetasve dhe personave të caktuar dhe të bllokuar (<https://sanctionssearch.ofac.treas.gov/>)

Përpara dhënies së një granti sipas kësaj thirrjeje, aplikuesit e suksesshëm do t'i nënshtrohen gjithashtu një *Përcaktimi të Përgjegjësisë së Para-dhënies së grantit*, i cili do të kryhet nga përfaqësuesit e CDF/IEAA. Gjatë kryerjes së këtij procesi, gjatë vizitës vlerësuese, përfaqësuesit e CDF/IEAA do të konfirmojnë nëse aplikuesi posedon: certifikatën zyrtare të regjistrimit të biznesit dhe se ka përmbushur detyrimet tatimore, si dhe do të kontrollojnë numrin e punonjësve, inventarin në dispozicion, objektet (në pronësi apo me qira), ndikimin mjedisor dhe të dhënat e performancës së kaluar për të zbatuar me sukses aktivitetet e grantit. Vetëm NMVM-të që përcaktohen se i plotësojnë kërkesat do të jenë përfutuese të grantit. Asnjë aktivitet që ka ndikim negativ mjedisor të papërmirësueshëm nuk do të merret parasysht. IEAA do të japë grante që trajtojnë probleme specifike dhe ofrojnë zgjidhje praktike.

PROCESI I APLIKIMIT

Kjo thirrje do të përfshijë një sistem konkurrimi me shumë nivele të aplikimit dhe një proces vlerësimi, i cili përfshinë Fazën 1 – Paraqitjen e Shprehjes së Interesit dhe Fazën 2 – Paraqitjen e Aplikacionit të Plotë për Grant.

Faza 1: Paraqitja e Shprehjes së Interesit (Koncept Dokumenti)

Gjatë fazës së parë, nga aplikuesit kërkohet që të paraqesin një Shprehje të Interesit (ShI)/Koncept Dokument, duke bërë një deklaratë përmbledhëse të problemit që synojnë të trajtojnë, lidhjen e aktiviteteve të propozuara me qëllimet e projektit Zhvillimi Gjithëpërfshirës Ekonomik, përshkrimin e aktiviteteve dhe detyrave kryesore të propozuara, rezultatet e pritshme (duke përshkruar se si rezultatet kontribuojnë në treguesit e rezultateve të projektit), duke përfshirë një plan menaxhimi, përvojën e mëparshme të aplikuesit dhe një buxhet të propozuar fillestar. ShI (Koncept Dokumenti) duhet të shpjegojë qartë dhe në mënyrë koncize qëllimin, rëndësinë, aktivitetet dhe rezultatet e pritshme të aktivitetit të grantit të propozuara në mbështetje të objektivave të Zhvillimit Gjithëpërfshirës Ekonomik të Kosovës, siç parashikohen në këtë thirrje. Të gjitha shprehjet e interesit duhet të dorëzohen në formatin e bashkëngjitur në [Shtojcën 1](#) të kësaj thirrje dhe nuk duhet të përmbajnë më shumë se 5 faqe.

Shprehjet e interesit mund t'i dorëzohen IEEA-së në çdo kohë përpara datës dhe afatit të fundit të mbylljes siç specifikohet në këtë thirrje. **Megjithatë, inkurajohen aplikimet e hershme.**

Aplikacionet mund të dorëzohen në tri gjuhë (anglisht, shqip dhe serbisht). Aplikuesit duhet të dorëzojnë formularin e shprehjes së interesit me shkrim në Departamentin e Granteve të IEEA në mënyrë elektronike, **përmes postës elektronike** në grants@kcdf.org ose **përmes kopjeve fizike** në ambientet e zyrave të CDF/IEEA në adresën: rr. Sejdi Kryeziu 32, Prishtinë, Kosovë. E gjithë korrespondenca e dërguar përmes postës elektronike dhe/ose përmes kopjeve fizike duhet të përfshijë numrin e thirrjes që i referohet projektit Zhvillimi Gjithëpërfshirës Ekonomik: **APS-2023-01 IEEA**.

Afati i fundit për dorëzimin e formularëve për shprehje të interesit është **8 shtator 2023, para përfundimit të orarit të punës në orën 16:00** sipas kohës lokale të Kosovës (Koha e Evropës Qendrore). Formularët për shprehje të interesit të dorëzuara pas kësaj date dhe ore nuk do të merren parasysh në këtë thirrje.

IEEA do të mbledhë një Komitet Përzgjedhës të Granteve (KPG) i cili do të vlerësojë aplikacionet për shprehje të interesit të paraqitura në përgjigje të kësaj thirrje në *baza të rregullta kurdo që pranohen ato*. Aplikacionet për shprehje të interesit do të vlerësohen bazuar në kriteret e specifikuar më poshtë (shih Seksionin 12 më poshtë). Në rast se aplikacioni për shprehje të interesit pranohet nga KPG, aplikuesi do të ftohet të dorëzojë Aplikacionin e Plotë për Grant siç përshkruhet në detaje në vijim.

Faza 2: Paraqitja e aplikacionit të plotë për grant

Pas vlerësimit të aplikacionit për shprehje të interesit, IEEA do të ftojë aplikuesit që kanë dorëzuar shprehje të interesit të suksesshme që të dorëzojnë aplikacionin e plotë për grant bazuar në konceptin dhe qasjen teknike të propozuar në shprehjen e interesit. Të gjitha aplikacionet duhet të dorëzohen përmes Formularit të Aplikacionit të Plotë për Grant të bashkëngjitur në [Shtojcën 2](#) të kësaj thirrjeje. Formulari i Aplikimit të Plotë për Grant kërkon që aplikuesit të zgjerojnë në detaje aktivitetin e propozuar të grantit, objektivat dhe rezultatet e pritshme, duke përfshirë një përshkrim të përfituesve dhe hisedarëve të synuar, duke përfshirë edhe një buxhet të detajuar të grantit. Aplikacioni i plotë për grant nuk duhet të përmbajë më shumë se 15 faqe.

VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA

IEEA do të mbledhë një Komitet Përzgjedhës të Granteve (KPG) që do të shqyrtojë në baza të rregullta si Aplikacionet për Shprehje të Interesit (SHI) ashtu edhe Aplikacionet e Plota të Granteve (APG) të paraqitura në përgjigje të kësaj thirrje për financim. KPG do të vlerësojë SHI-të dhe FGA-të bazuar në kriteret e mëposhtme:

Faktori	Pikë	Objektivat e Projektit
Qëndrueshmëria e biznesit dhe potenciali i rritjes	40	Sigurojnë që biznesi të ketë një plan të qartë dhe të realizueshëm për të arritur qëllimet e tij, të gjenerojë të ardhura dhe të jetë në gjendje të qëndroj aktiv në periudhë të gjatë kohore. Marrin parasysh potencialin për të zgjeruar veprimtarinë e biznesit, për të arritur tregje të reja dhe për të arritur përfitim më të madh me kalimin e kohës.
Inovacioni dhe ideja unike	10	Nxisin biznesin të ofrojë produkte, shërbime ose veprimtari unike që e dallojnë atë nga konkurrentët dhe ua shton vlerën klientëve të tyre.
Ndikimi social dhe mjedisor	20	Promovojnë biznesin që ka ndikim pozitiv në mjedis ose shoqëri, të tilla si uljen e emetimeve të karbonit, promovimin e ambientit të qëndrueshëm ose krijimin e mundësive të punësimit për grupet e nënpërfaqësuar.
Ekipi menaxhues dhe aftësitë	30	Vlerëson përvojën, aftësitë dhe kapacitetin e ekipit menaxhues, për të ekzekutuar me sukses projektin e propozuar dhe për të rritur biznesin.

Pas përfundimit të fazës së parë të vlerësimit, të gjithë aplikuesit do të informohen për statusin e aplikacionit të tyre. Aplikuesit e suksesshëm që kanë tejkalluar pragun minimal prej **60 pikësh** do të marrin një njoftim me shkrim se shprehja e tyre e interesit (SHI) është pranuar.

Pas përfundimit të suksesshëm të fazës së SHI-së, aplikuesit e suksesshëm do të ftohen të dorëzojnë aplikacionin e plotë për grant brenda një afati të caktuar. KPG do të vlerësojë aplikacionin e plotë për grant bazuar në kriteret e renditura më sipër. Sipas informacionit të dhënë, kërkohet që nga shqyrtimi i aplikacioneve të plota nga KPG aplikuesit të arrijnë një rezultat minimal prej **70 pikësh**.

Shënim:


IEEA rezervon të drejtën të financojë cilindo ose asnjërin nga aplikacionet e paraqitura. Lëshimi i kësaj thirrjeje nuk përbën në vetvete ndonjë përkushtim për shpërbllim nga ana e projektit IEEA dhe as nuk e detyron atë të paguajë për shpenzimet e shkaktuara për përgatitjen dhe dorëzimin e shprehjes së interesit opo aplikacionit të plotë për grant. Më tej, IEEA rezervon të drejtën të refuzojë cilindo ose të gjitha aplikacionet e pranuar nëse një veprim i tillë konsiderohet se nuk është në përputhje me rregulloret e USAID/CDF. **Aplikuesit marrin përsipër rrezikun e dorëzimit të aplikacioneve; nëse rrethanat pengojnë dhënie të një granti, të gjitha shpenzimet e përgatitjes dhe dorëzimit të aplikacionit bien mbi aplikuesin.**



ULJA E MUNDËSISË SË ÇRREGULLIMIT TË TREGUT

IEEA do të sigurojë procedura të qarta, transparente dhe konkurruese për grantet e financuara nga projekti me synimet kryesore për të përfshirë rezultatet e pritura dhe uljen e mundësisës së çrregullimit të tregut. Propozimet për grante do të vlerësohen dhe miratohen me qëllimin për të shmangur çrregullimin e tregut ose për të favorizuar një prodhues, grup biznesi ose interesi mbi një tjetër. Në përmirësimin e konkurrencës së një sektori, nënsektori ose grupi ndërmarrjesh të caktuar, grantet do të nxisin një terren të barabartë për firmat konkurruese dhe komplementare në të njëjtin zinxhir vlerash. Qëllimi i Skemës së Granteve të Qëndrueshme të IEEA nuk është që të përdoret si financim i drejtpërdrejtë ose ofrimi i subvencioneve për organizatat prodhuese, por për të avancuar konkurrencën brenda zinxhirëve të vlerës së synuar të IEEA. Fondi nuk do të përdoret për të ofruar subvencione të padrejta që konkurrojnë me institucionet financiare ekzistuese. Fondi do të strukturohet dhe menaxhohet për të siguruar që ai të mos deformojë tregun vendas.

APLIKIMI PËR GRANT, VLERËSIMI DHE ZBATIMI





SHTOJCAT

- A. Formulari i shprehjes së interesit**
- B. Formulari i plotë i aplikacionit për grant**